



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 01.10.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT “Rikonstruksion i Godinës së Farmacisë dhe Shëndetit publik”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punime ndërtimi- 45210000-2

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 234,576,290.89 (dyqind e tridhjetë e katër milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë pik tetëdhjetë e nëntë) **Lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, autoriteti/enti kontraktor, Njësia e Prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a) *Formulari i ofertës dhe çmimit, sipas shtojcës 1 dhe 2;*
- b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c) *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

**Argumentim:** *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP I ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, të mjedisit dhe të cilësisë në saldim. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :
  - Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Certifikatë **EN-ISO 3834-2:2021** ose ekuivalente mbi “Sisteme të menaxhimit të cilësisë në saldim”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

- Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentimi:** Kerkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga

madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

EN-ISO 3834-2:2021 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (struktura metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilësisë së ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të çojnë në carje të nyjeve .

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

**2.1.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licencë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.**

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiron për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “e Hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”*. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e fondit limit/lotit për të cilin konkuron dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b. dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i fondit limit.

#### **Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.**

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

#### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
  - Certifikatën e marrjes në dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
  - Fatura tatimore përkatëse.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Certifikatën e marrjes në dorëzim/ Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
  - Fatura tatimore përkatëse.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” ku qartazi përcaktohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga*

autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkepunitimit; me marreveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tendër as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

### **3. Liçenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi për kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **NP-3 E** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industrial, veshje fasada;

- **NP-12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit;
- **N.S-1 A** Punime për prishjen e ndertimeve;
- **N.S-2 A** Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre;
- **NS-4 C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **NS-12 B** Impiante teknologjik, termik dhe të kondicionimit;
- **NS-14 B** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.;
- **NS-18 A** Punime topogjeodezike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024* si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton: *Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.*

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gërmimi në tokë.	Gërmim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m3,shkarkimi ne auto Gërmim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III F.V. Gërmim, transport dhe mbushje	0-20 mln leke	88,084.16 Leke
NP-3 E	Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada	Totali i punimeve për gjithë objektin meqënëse është Rikonstrukcion	201-400 milionë	234,576,291 Leke
NP-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	0-20 mln leke	2,497,730.92 Leke
N.S-1 A	Punime për prishjen e ndertimeve	Prishje mur tulle me pastrim Prishje soleta b/a Prishje kollona, trare b/a	0-20 mln leke	4,829,341 Leke

		Prishje suvatim i jashtem Prishje suvatim muri i brendshem Prishje çatie ekzistuese me tjegulla Prishja e rrjetit ekzistues elektrike Prishja e rrjetit ekzistues hidraulik Prishje e shtresave ekzistuese ne shesh		
N.S-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre	Totali i vleres Sistemi i Furnizimit me uje Sanitar	0-20 mln leke	3,451,628.52 Leke
NS-4 C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	Veshje me pllake majolike Patinim muri allçi (stuko) Patinim tavani allçi (stuko) Suva solete > 4 m, me drejtues, me pompe Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Veshje fasade me alukobonde Torkretim me llac cemento 1: 2, t = 3 cm Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25 F V dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham F V dyer d/alumini plastike me dopio xham F V dyer te brendeshme metalike te blinduara. Boje hidroplastike Boje hidroplastike cilesi e larte	51-100 mln leke	54,747,658 Leke
NS-12 B	Impiante teknologjik, termik dhe te kondicionimit	Totali i punimeve Sistemi i Ajrit te Kondicionuar	21-50 mln leke	35,210,157 Leke
NS-14 B	Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Totali i punimeve Sistemi Elektrik	21-50 mln leke	31,078,148.45 Leke
NS-18 A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 ln leke	1,813,808.71 Leke

**3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar të paktën 70 (shtatedhjetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:**

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar;
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 77 pika 1 gërma dhe pika 4, si dhe në VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe neni 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe



*mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.*

*Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve dhe zërave të punimeve që përfshihen në preventivin dhe grafikun e punimeve.*

**3.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:**

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier Hidroteknike;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Elektronik;
- 1 (një) inxhinier mekanik.
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) arkitekt;

*Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të punimeve në objekte. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8.

Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin “ Sistemi i Shkarkimit te ujrave te ndotura e te shiut ” dhe kontretisht këtu përfshihen të gjithë zërat e rubrikave me emërtesë (Sistemi i furnizimit me ujë sanitar. Sistemi i shkarkimeve te ujrave të zeza), sipas parashikimeve në projektin Hidrosanitar.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin “ Sistemi Elektrik”, sipas parashikimeve në projektet Elektrike përkatëse.
- **Inxhinier Elektronik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektronike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin “ Sistemi i Telekomunikacionit ”, sipas parashikimeve në projektet Elektronik përkatëse.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventivin “Sistemi i Ajrit te Kondicionuar”, sipas parashikimeve në projektin HVAC.
- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të themeleve, kuotave të tubacioneve të furnizimit me ujë, tubacioneve të kanalizimit të ujrave te zeza dhe të bardha, kuotave të shtresave etj.
- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve sipas parashikimeve në projektin arkitektonik.

**3.3 Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjësin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:**

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

*Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese, si provë paraprake do të mjaftojë deklarata.*

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Kreun I/2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit“, përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000

*(tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.*

**3.4 Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin).**

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin*", ku citohet se: "*Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit*", për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

**4 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:**

- a) 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").
- b) 2 (dy) punonjës me certifikatë "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) punonjës "*Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*").
- c) 8 (tetë) punonjës me certifikatë Punime ne Lartesi që të disponojnë certifikatë trajnimiti "*Për punime në lartësi*", sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës (titulli dipomës/certifikatës së kualifikimit), numri amzës, institucionin që ka lëshuar kualifikimin përkatës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatës lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” duhet të jetë në kantier në rast aksidentesh në punë. Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” duhet të jetë në kantier për marrjen e masave parandaluese të aksidenteve në punë.

### **Kritere të tjera:**

- 5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi certifikatë profesionale përkatëse lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, të njohur nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:**

- 1 (një) Teknik ndërtimi;
- 1 (një) Teknik mekanik;
- 1 (një) punonjës specialist IT;
- 3 (tre) punonjës instalues të sistemeve termo-hidraulike;
- 1 (një) punonjës konstruksione metalike;
- 2 (dy) punonjës për sistemet ngrohje-ftohje;
- 4 (katër) punonjës elektrikistë;
- 2 (dy) punonjës elektroteknik;
- 1 (një) punonjës elektro-mekanik;
- 1 (një) punonjës mekanik;
- 3 (tre) punonjës saldator;
- 4 (katër) punonjës bojaxhi;
- 4 (katër) punonjës muratorë/suvatues;
- 3 (tre) punonjës karpentier;
- 3 (tre) punonjës betonues;
- 2 (dy) punonjës hekurkthyes;
- 3 (tre) punonjës hidroizolues;
- 3 (tre) punonjës pllakashtrues;
- 5 (pese) punonjës për punime duralumini;
- 3 (tre) punonjës për punime gips (sisteme të thata);
- 3 (tre) punonjës Marangoz/Mobilier.

Për stafin teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale e punës;
- b) diplomën/dëshminë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm leshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore në Republikën e Shqipërisë;
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës (titulli diplomës/certifikatës).

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emër/mbiemër, profili i punës (titulli diplomës/certifikatës se kualifikimit), numri amzës, institucionin që ka leshuar kualifikimin përkatës.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike

(të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me zërat e punimeve që do të kryhen sipas projekt-preventivit duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetëror, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “*regjistrat profesionale*” të AKAFP-se. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuar në specifikimet teknike.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Teknik mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës specialist IT** është i nevojshëm për montimin dhe operimin e pajisjeve elektronike apo komponentëve të tyre, nën mbikëqyrjen e inxhinierëve.
- **Punonjës instalues të sistemeve termo-hidraulik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulikë/termo-hidraulikë , sipas zërave të preventivit të punimeve si sistemi sanitare civile dhe industrial , sisteme termo-hidraulike të ngrohjes , klimatizimit etj.
- **Punonjës konstruksione metalike** është i nevojshëm për përpunimin, prerjen, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik, në konstruksione prej metali, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës për sistemet ngrohje-ftohje** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të kondicionimit dhe aspirimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës elektrikiste** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës elektroteknik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektroteknike , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës elektro mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektro mekanike , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve mekanike , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës saldator** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës bojaxhi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lysterjes, sipas zërave të preventivit.
- **Punonjës muratorë/suvatues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të muraturës sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës karpentjer** është i nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e zërave të punës sipas preventivit të punimeve.

- **Punonjës betonues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të strukturave prej betoni të armuar muraturës sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës hekurkthyesa** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të hekurit, referuar zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës hidroizoules** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës pllakashtrues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave dhe vendosjen bordurave të betonit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës për punime duralumini** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të vendosjen e dyerve dhe dritareve , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës për punime gips (sisteme të thata)** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës Marangoz/Mobilier** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të veshjes së fasadës me panele HPL , sipas zërave të preventivit të punimeve.

**6 Për Pajisjet të përcaktuara në preventiv sipas tabelës Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara. Për materialet e kërkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmiteti CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në Specifikimet teknike.**

**TABELA:**

Nr.	Emërtimi i pajisjes	Specifikimet teknike referuar katalogëve/skedat teknike dhe nr. i faqes se katalogëve/skedat teknike për çdo artikull/pajisje etj.	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	F. Kaset + hidrant zjarri. Llamarine çeliku e emaluar me ngjyre te kuqe RAL 3000 - UNI 9227,me baze rezine. Dimensionet ( 370x610x190)mm, tub fleksibel 30 m, Aksesoret: saraqineske nderprerese 1½", lançe + zorre uji DN 45. Pjesa e perparme e mbyllur me çeles.		
2	Grupi i MNZ per sistemin e hidranteve sipas EN12845 i perbere nga 2 Pompa elektrike 2x11 kW (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep : Q = 27,6 m3/h; H=45 mkH2O;		
3	F.V Pompe e furnizimit me uje sanitar ON/OFF e perbere nga 2 pompa (1 ne pune + 1 stan by) Q=12.39 m3/h; H=35 m; 3 x 400 V; 10.3 A; Hermetizimi IP55; Lidhjet me tubacione me fileto Rp 2"; Helikat dhe Pjesa Hidraulike Celik Inox.		
4	Autokllave Karakteristikat Teknike: -Autokllave me membranë -Presioni maksimal 10 bar, -Kapaciteti 300 lit -De = 6550 -H = 1520 -Lidhjet: F Ø 1 1/4"		
5	Ventilator In Line - Kapaciteti: 360 m³/h; - Diameter: 125 mm - Fuqi nominale max – 56 W; - Niveli I zhurmës- 30 dB I kompletuar me sensor temperature dhe komandimi.		
6	Pompe thithëse për ujerat e bardha te depos me karakteristikat teknike : Prurja : 15 m³ / h Prevalenca : 10 mkH2O Tubi i shkarkimit : DN 65 Tensioni : 3F~400 V, 50 Hz Fuqia elektrike : 2.1 kW		

7	Njesi e jashtme -Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes : 151.0 /169.5 kW . Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : Ft: 44.0 kW / Ng: 45.1 kW / 380-415V / 78.7 A /80.6 A / 3 F ~ 50Hz . Pesha 995 kg.		
8	Njesi e jashtme - Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes : 111.9 /125.5 kW . Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : Ft: 32.7 kW / Ng: 33.0 kW / 380-415V / 58.5 A /59.0 A / 3 F ~ 50Hz . Pesha 745 kg.		
9	Njesi e jashtme - Kompresor inverter VRF (Kompresor me pompe nxehtesie VRF). Kapaciteti ftohes / ngrohjes : 101.5 /114 kW . Fuqia elektrike / tensioni / intensiteti /ushqimi : Ft: 29.15 kW / Ng:30.0 kW / 380-415V / 52.1 A /53.6 A / 3 F ~ 50Hz . Pesha 745 kg.		
10	Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 1950 m <sup>3</sup> /h Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve 2x0.41 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 14.0 kW Kapaciteti termik ngrohje: 16.0 kW Kapaciteti i rekuperimit: 61.8 %		
11	Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 2950 m <sup>3</sup> /h Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve 2x0.54 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 22.0 kW Kapaciteti termik ngrohje: 25.0 kW Kapaciteti i rekuperimit: 66.9 %		
12	Njesi Rekuperatore Ajri Volumi i ajrit max : 3900 m <sup>3</sup> /h Presioni statik 150 Pa Fel.e vetilatoreve 2x0.87 kW 1F~230V,50Hz Kapaciteti termik ftohje: 28.0 kW Kapaciteti termik ngrohje:31.5 kW Kapaciteti i rekuperimit: 62.7 %		
13	Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.20/2.50 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=500 m <sup>3</sup> /h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz.		
14	Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 2.80/3.20 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=500 m <sup>3</sup> /h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz.		
15	Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Murale, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 5.00/5.80 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=500 m <sup>3</sup> /h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz.		
16	Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Tavanore, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 5.00/5.60 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=950 m <sup>3</sup> /h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz		
17	Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Tavanore, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 6.30/7.10 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=1400 m <sup>3</sup> /h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz		
18	Njesi e brendshme VRF me zgjerim direkt - Tavanore, kapaciteti ne ftohje/ngrohje 7.10/8.00 kW, prurja maksimale e ajrit Vmx.=1400 m <sup>3</sup> /h, furnizimi elektrik 1F~230V~50Hz		
19	" F.V. Tipi 1_Ndricues LED 120x20 cm, 4000 lm, 4000K, 40W Version T26, Shkalla e mbrojtjes IP20, Ik30 "		
20	"F.V.Tipi 2_ Ndricues 60x60, LED Zante (ose i ngjashem), I pershtatshem per ambiente ne tavan te varur me strukture te ekspozuar. Shkalla e mbrojtjes IP43,Pesha: 3.52kg, Temperatura e ngjyres: 4000K, Fluksi i ndricimit: 4800lm,Fuqia e ndricimit: 34w "		
21	" F.V. Tipi 4_Ndricues tavanor, ne forme rrethore LED. Dimensioe: Ø 160mm, Pesha:0.9kg, Shkalla e mbrojtjes:IP44, IK07 Fuqia: 18W ,Temperatura e ngjyres: 3000K, 2400lm ,220/240V,50- 60 Hz. "		
22	F.V.Tipi 5_ Ndricues muror LED, 2700lm, IP66, IK09, 26W, 63mmx158mm		
23	F.V. Ndricues evakuimi (EXIT), rezistent ndaj zjarrit sipas (EN 60695-2-10) deri ne temperaturen 850 <sup>0</sup> C, IP-40, IK 07, Led 8,5 VA, 100 000 ore pune, bat.NiCd me autonomi 1 ore, 220/230V, 50 Hz		
24	F.V. Ndricues emergjence, rezistent ndaj zjarrit sipas (EN 60695-2-10) deri ne temperaturen 850 <sup>0</sup> C, IP-42, IK 07, Led 2,4 VA, jetegjatesia mbi 10 vjet, bat.NiCd me autonomi 1 ore, 220/230V, 50Hz		
25	F.V. Ekrane Interaktive		
26	F.V. Gjenerator diesel S = 150 kVA / , Un =400V, silencioze, deri 60db per 7m, komplet me kuadrin automatik dhe gjithcka te nevojshme sipas standartit.		
27	F.V .U.P.S. 60 KVA, 3 fazor 10 min, autonomi.		



28	F.V . Kompesator fuqie cos ø 50 Kvar, 3 fazor.		
29	F.V. Central telefonik PABX 4 hyrje / 40 dalje		
30	F.V. Central zjarri [Fire Alarm Panel, Control M Control/Intelligent Addressable], me mundesi komunikimi ne rrjet centralesh nepermjet kartave essenet, i adresueshem ,230V /12V, 24 h/aut. 127 elemente per loop (komplet centrali, modul operimi, LCD panel, Karte Loop, Karte RL etj.		
31	F.V. Central controlling unit [Digital Int. System Manager X-DCS2000/EN] EN 54-16 certified and EN 60849 compliant 8 zona dhe me mundesi zgjerimi, 9 hyrje audio, 4 dalje audio, me mundesi komunikimi ne rrjet me centralin e zjarrit apo zgjerimi.		
32	F.V. Multi-channel Power Amplifier 1x500 ose (sipas sistemit te zgjedhur) EN 54-16 certified and EN 60849 compliant		
33	F.V. NVR 24, IP Kanale, Up to 32-ch IP cameras input, Third-party network cameras supported, ONVIF protokoll, Up to 5 Megapixels resolution recording, HDMI and VGA output at up to 1920x1080P resolution, HDD quota and group management, RAID Function		
34	F.V. Kamera te brendshme, IR Dome kamera 3MP 2.8mm, 3MP high resolution, HD real-time video, 3D DNR & DWDR & BLC, IR LEDs: up to 30m, IP66, Vandal-proof, PoE		
35	F.V. Kamera te jashtme, IR Bullet kamera 3MP, VF Lens 2.8-12 mm, 3 megapixel high resolution, HD video output, Low illumination, 3D DNR & DWDR & BLC, IP66 rating, IR range: up to 30m, True day / night, POE interface.		

- *Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj tabele është kusht skualifikues.*

Operatorët ekonomikë, **për artikujt/pajisjet e cilësuar në tabelen e mesiperme**, duhet të paraqesin katalogë ose **skedat teknike të prodhuesit/ve** me të dhënat teknike. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt/pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre. Në kataloge do të markohet vetëm një paisje për secilin artikull. **Katalogu duhet të jetë i përkthyer nga një përkthyes i licënsuar dhe i noterizuar në gjuhën Shqipe. Nëse nuk paraqitet sipas kësaj pike është kusht për skualifikim.**

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur, për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të natyrës së veçantë të artikujve/pajisjeve që do të përdoren në funksion të realizimit të zërave përkatës referuar preventivit të punimeve që parashikon projekti objekt kontrate dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit. Njësia e prokurimit në përzgjedhjen e pajisjeve për të cilat ofertuesit do të paraqesin katalogë ose skeda me të dhënat teknike certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar , është bazuar në vlerën e konsiderueshme të tyre, referuar çmimeve të përcaktuara në preventivin e punimeve të dërguar nga struktura porositëse, në funksion të përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës objekt prokurimi.

**7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit .**

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024* ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: grafikun e zbatimit të punimeve”.

**8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:**

Nr	Emri i makinerive	Njësi	Sasi	Statusi
1	Autovinç	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Vinç kulle deri ne 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Autovinç me kosh, me krah mbi 25m	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Trapano	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Minifadrome MT	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Betoniere 500l	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m3 MT	copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator thellësie	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Vibrator sipërfaqësor	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Eskavator 0.25 m3 me gome MT	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Elektro-saldatriçe	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15 -20 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse të qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për pajisjet dhe makineritë ngritëse duhet të paraqitet raporti i inspektimit të tyre.
- e. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

## **9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi si dhe bazuar në Ligjin Nr. 8308, dt. 18/03/1998 “Për Transportet Rrugore” dhe ndryshimet e tij, Ligjin Nr. 8378, dt. 22/07/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimin Nr. 15, dt. 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, Udhëzimin Nr. 20, dt.10.10.2007, për "Modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar si dhe Vendimeve përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

**Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkohen referuar zërave të preventivit të punimeve.**

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

- **Autovinç** do të përdoret për ngritjen dhe lëvizjen e objekteve të rënda. Ai do të përdoret kryesisht për të transferuar materialet , pajisjet, ose strukturat e mëdha dhe të rënda.
- **Vinç kulle deri ne 5 ton** do të përdoret për të ngritur dhe të transportojë materialet e ndërtimit, si çimento, çelik, dhe pllaka ndërtimi, nga nivelet e poshtme në nivelet e larta të ndërtimit.
- **Autopompë betoni** është thelbësore për ndërtimin e objektit , pasi lejon që betoni të shpërndahet në lartësi të mëdha pa pasur nevojë për ndihmën e ndihmësve të tjerë. Autopompa është një mjet efikas që ndihmon në shpejtimin e procesit të ndërtimit dhe siguron cilësi të lartë në shpërndarjen e betonit.
- **Autovinç me kosh, me krah mbi 25m** ofron një qasje të sigurt dhe efikase në lartësi të mëdha dhe është një mjet shumë i vlefshëm për ndërtimi e objekti që kërkojnë punë në lartësi pasi sipas preventive ka 2144 m<sup>2</sup> , veshje fasade me panele HPL dhe Brisoleil me panele HPL
- **Matrapik** është i nevojshme për të kryer punimet e prishjes sipas preventivit .
- **Trapano** është një paisje shumë funksional që do të përdoret kryesisht për të bërë vrima në materiale të ndryshme , Instalimi i Elementeve të Ndërtimit .Shpime për Montimin e Pajisjeve: Përdoret për të bërë vrima për montimin e pajisjeve të ndryshme, si armatura ndriçimi, mbajtëse për raftet, dhe pajisje të tjera në mure dhe struktura të tjera.
- **Minifadroma MT** është një makinë e përdorur në ndërtim dhe punime të ndryshme për të kryer operacione të shkuljes dhe lëvizjes së materialeve , Largimi i Materialeve të Padyshiruara , Përgatitja e Bazamenteve dhe Themeleve, Pastrimi dhe Rregullimi i zonave në ndërtimit , duke ofruar fleksibilitet dhe efikasitet në kryerjen e punëve që kërkojnë lëvizjen dhe trajtimin e materialeve.
- **Autobot uji** është një makineri e përkohshme, e cila do të shërbejë për furnizimin me ujë në zona te caktuara të punimeve, ose në raste emergjence të ndërprerjeve të ujit.
- **Betonjere 500 l** është një makinë esenciale në ndërtim, e cila përdoret për të përzier betonin në kantierin e ndërtimit.
- **Autobetonjere kantjeri 2.5-3.5m<sup>3</sup> MT** dhe autopompë betoni janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (Shtrese betoni C 16/20; si dhe me punimet e rubrikës “ Punime Betoni dhe Betonarmeje”, etj).
- **Vibrator thellësie betoni** është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- **Vibrator sipërfaqësor betoni** është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- **Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton dhe Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 15 -20 ton** janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (Transport i mbeturinave me auto deri 12km landfilli i Sharres perfshire dhe taksen e depozitimit ).
- **Eskavator 0.25 m<sup>3</sup> me gome MT** janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m<sup>3</sup>,shkarkimi ne auto )
- **Autobetoniere** janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (Shtrese betoni C 16/20 , etj).
- **Elektrosaldatrice** është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (saldime të ndryshme profilesh metalike, ele dhe llamarine).
- **Pompa e suvatimit** është një pajisje që do të përdoret për të shpërndarë dhe aplikuar suvatimin në mure dhe sipërfaqe të tjera në ndërtim

**10 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda 1 (një) punonjës eskavatorist; 3 (tre) punonjës automakinist dhe 2 (dy) shofer.**

Për punonjësit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.  
*(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikën e sipërcituar, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit eskavatoristë, automakinist dhe buldozeriste, emër/mbiemër, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmërisë së dëshmisë së aftësisë profesionale.*

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.* Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim:**

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit. Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese

për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do të jetë kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Lidhur me parashikimet e përcaktuara në DST "Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera", Nj.P. vlerëson se:

**Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:**

- **Kapacitetet ekonomike e financiare, kërkuar sipas pikës 2.2 të Kapacitetit ekonomik e financiar, të KVK, të Dokumenteve të Tenderit.**
- **Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3, të Kapacitetit teknik, pika 1 të KVK, të Dokumenteve të Tenderit.**
- **Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 3, të Kapacitetit teknik.**
- **Stafi inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës 3.2 të Kapacitetit teknik, dhe stafit të punonjësve të kualifikuar pika 4 të KVK (Kapacitetit Teknik), të Dokumenteve të Tenderit.**

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi xhiroja vjetore, përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, stafi inxhinierik (drejtuesit teknik) dhe staf punonjës, vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen të AK së ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente". Specifikimet teknike janë pjesë e projektit të zbatimit të hartuara nga projektuesi.*

*Veprimtaria profesionale dhe kapaciteti teknik sipas pikave të citara më sipër janë vendosur nga Eksperti i fushës.*

*Detajet e projektit të zbatimit dhe preventivi i punimeve do të publikohet si pjesë përbërse e procedurës në sistemin elektronik të APP-së.*

**NJËSIA E PROKURIMIT:**